



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 116, Datë 10.06.2024

MBI

DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË ERE-S PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “HYDROBORSH” SH.P.K. PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenev 9, pika 8, dhe 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.06.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr.770/13 prot., datë 10.06.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HYDROBORSH” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të centralit fotovoltaiik nga hidrocentralet “Fterra” dhe “Fterra 2” me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 67, datë 06.06.2012.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 770 prot., datë 12.03.2024, ajo ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” sh.a.
- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar nga shoqëria, ERE me shkresën nr. 770/2 prot., datë 08.04.2024, i ka evidentuar shoqërisë informacionin/dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.

- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 770/4 prot., datë 25.04.2024, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit u konstatua nevoja për plotësim të mëtejshëm të tij, ndaj ERE i'u drejtua përsëri shoqërisë me kërkesën për plotësim dokumentacioni nëpërmjet shkresës nr. 770/5 prot., datë 20.05.2024. Në vijim, me shkresën nr. 770/9 prot., datë 30.05.2024 shoqëria ka përcjellë në ERE dokumentacionin e kërkuar.
- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit rezultoi se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pika 1 dhe 2 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.
- Shoqëria ka shlyer detyrimet për pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9, pika 8 të Rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.
- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi kuotat për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. si mjet si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse, “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” sh.a.
2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “HYDROBORSH” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “HYDROBORSH” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrimit tregtar të QKB-së brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.
4. Shoqëria “HYDROBORSH” sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.
5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “HYDROBORSH” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI